Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/102
Datë: 16.02.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 06.02.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Telekomi i Kosovës - Qendra për Trajnim dhe Zhvillim (QTZH), në Prishtinë me adresë Rr.Agim Ramadani p.n, Bregu i Diellit, për periudhën 06.02.2018 deri 06.02.2021 me kualifikimin:

   1.1. Shitja dhe Shërbimi i Klientit, Niveli III sipas KKK me 20 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi u dërgohet:
   - Telekomi i Kosovës - Qendra për trajnim dhe Zhvillim (QTZH);
   - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së